



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Edhe sa gra të vrara?

Ndërkohë që po protestohet nëpër komuna të ndryshme kundër vrasjes së grave, mëngjesi i sotëm na gjen me një vrasje tjetër. Mediat sot raportuan se në Gjakovë ndodhi edhe një vrasje e një gruaje 61 vjeçare nga arma e bashkëshortit të saj. Pas vrasjes i dyshuari kryesor, bashkëshorti i tashmë së ndjerës, kishte ikur nga vendi i vrasjes. Tutje, policia kishte deklaruar që dyshohet për vrasje aksidentale.

Edhe kësaj rradhe, policia doli me një verzion i cili më parë presupozon pafajësinë e kryesve se sa faktet se si po humbin jetën viktimat e vrara. Javë më parë, ishim dëshmitarë të një tragjedie, ku si pasojë e dhunës në familje, me armë zjarri, humbën jetën një vajzë 9 vjeçare dhe një grua 40 vjeçare. Edhe në atë rast pati arsyetime nga policia dhe prokuroria se vrasësi me armën AK-47, kishte shkuar tek familja e tashmë të ndjerës, që t'i kërkoj asaj të rikthehet në shtëpinë e tij.

Organizatat e shoqërisë civile të përkrahura nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) organizuan disa protesta në disa komuna të Kosovës, protesta të cilat do të vazhdojnë edhe gjatë kësaj jave. RrGK dhe e gjithë shoqëria kërkon hetim të pa-anshëm dhe objektiv në rastet e dhunës dhe vrasjes së grave, dënim meritor për vrasësit por edhe përgjegjësi institucionale karshi trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës e vrasjeve ndaj grave në përgjithësi.